

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e tretë e K.K-së,s, e cila do të mbahet më **31.03.2022** (e enjte) duke filluar në ora **10:00h.**

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Pruarja e vendimit për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore për transfer dhe subvencione për ndihmë momentale personave fizik dhe juridik;
3. Shqyrtimi i draft Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane;
4. Prerja e vendimit për dhënjën e Pajtueshmerisë për dhënjën e vendgjahishtës në teritorin e Komunës së Novobërdës;
5. Raporti i punës nga Kompania EcoHigena;
6. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ne Sallen e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 25.03.2022
Në: Novobërdë



zonj.Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës



Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dytë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 28.02.2022, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit znj. Mirjana Simijonovic, zv. Kryesuesi i Kuvendit zt. Ramush Mehmeti, Nënkryetari i Komunës zt. Svetislav Ivanovic, antarët e Kuvendit: Ivana Ivanovic, Stefan Kovacevic, Stojan Stanojevic, Dragana Dimic, Violeta Milosevic, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobriboje Djordjevic, Vlora Vllasaliu, Abdyl Gashi, Ivica Cenic, Drejtori i Financave zt. Milos Denic, Drejtori i Sherbimeve Publike zt. Gafurr Vllasaliu, Drejtori i Administratës Serboljub Djokic, përfaqësues nga kabineti i Kryetarit, përfaqësuesi i OSBE-së Edmond Hyseni, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit e cila pasi pershendeti të gjithë të pranishmi konstatoj korumin prezent janë të gjithë antarët e Kuvendit 15 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Propozim plani i punës së Kuvendit;
3. Raporti Vjetor Financiar;
4. Aktivitetet rreth luftimit të pandemisë;
5. Raport nga D.SH.P.M.SH për aktivitetet e ndërmarrura gjatë periudhës së reshjeve të Borës;
6. Formimi i komisionit për vlerësimin e dhënjës së tokës Komunale në shfrytëzim;
7. Formimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave;
8. Formimi i komisionit për emrimin e rrugëve;
9. Pruarja e vendimit për Plotësim - Ndryshimin e Planit Zhvillimor Komunal;
10. Pruarja e Vendimit për kompletimin e komitetit për Komunitete;
11. Pruarja e vendimit për plotësim ndryshimin e Rregullores Komunale për taksa dhe gjoba;
12. Pruarja e vendimit për shpalljen e Ankandit publik për shitjen e automjeteve të Komunës që janë jashtë përdorimit;
13. Të ndryshme.

Kryesuesja i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Xhejlane Behluli, nga kabineti i kryetarit pasi pershendeti të pranishmit tha: kerkoj nga ju vetem të ndryshohet riformulimi i pikës në rend dite pika e nëntë, riformulimi të bëhet marrja e vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Kryesuesja tha: i kam edhe dy propozime nga kabineti i kryetarit, propozimi i parë është Pruarja e vendimit për plotësim ndryshimin e Rregullores Komunale për Taksa dhe Gjoha dhe Pruarja e vendimit për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve të Komunës që janë jashtë përdorimit.

Pasi nuk pati propozime tjera aprovohet rendi i ditës me 13 vota për, 2 të përmbajtur nga antarët prezent të Kuvendit me propozim ndryshimet.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar e Kuvendit.

Pika e dytë: Propozim plani i Punës së Kuvendit.

Kryesuesja tha: ne kemi mbajtur një takim me antarët e Kuvendit që kanë qenë në komision për hartimin e planit të punës dhe Drejtorët Komunal, kemi pranuar propozimet, planin e punës e keni marrë me material, nese keni ndonjë propozim/ diskutim urdhëroni.

Stojan Stanojevic pasi pershendeti të pranishmit tha: në gusht nuk ka asnjë pikë.

Kryesuesja i'u pergjigj se muaji gusht është muaj i pushimeve.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: në nëntor vetem një pikë është rreth aktiviteteve për luftimin e pandemisë, pasi që nëntori është para sezones së dimrit kishte qenë mirë që të futet edhe parapregaditje për sezonin e dimrit.

Kryesuesja tha: kjo është vetem kornizë, pika do të shtohen varësisht nga propozimet që do ti kemi.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 13 vota për, 2 apstenimë aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

APROVOHET Planin e Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2022.

Pika e tretë: Raporti Vjetor Financiar;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Financave Milos Denic.

Milos Denic pasi pershendeti të pranishmit tha: para jush e keni raportin financiar vjetor për vitin 2021, po besoj që e keni marrë materialin me kohë dhe e keni shqyrtuar, në krahasim me raportet tre mujore dhe gjashtë mujore kjo është një formë ndryshe formë e standardizime si dhe janë përfshirë të gjitha kodet buxhetore, po kalojmë te neni 14 të ajo tabele janë të përfshira 90% të shpenzimeve dhe qarkullimeve financiare komunale aty keni buxhetin final në fribalanc si dhe forma e realizimi të këtij buxheti si të hyrat dhe të daluarat në mënyrë detale, tabelë pas tabele janë zbërthyer aty, kemi edhe të hyrat tona kapitale si dhe të dalurat, të hyrat për këtë vit që janë bartur, grandet e donatorëve të gjitha janë na raport. Realizimi i të hyrave për vitin 2021 është 686,000€, të hyrat tatimore janë 84,000€, të hyrat jotatimore janë 342,000€, të hyrat nga donatorët 342,000€. Paga dhe medijtje 2.701.000€, mallra dhe shërbime 309.000€, shpenzime komunal 70.000€, transfere dhe subvencionet 53.000€, investimet kapitale 400.000 të gjitha këto informata i keni në tabelat të sqarime, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: është mirë që ka ardh ky raport financiar vjetor, unë personalisht nuk e kam lexuar pasi që nuk e kam marrë materialin në kopje fizike, pasi që në telefon po e kam problem me analizu. Kërkoj që në të ardhmen çdo material që vjen të na dergohet edhe në kopje fizike, jo të vihet vetem në kopje elektronike, do ta perkrahi pasi që është mirë që së paku njëherë ky raport ka ardhë në Kuvend.

Abdyl Gashi tha: pajtohem me parafolsin që materiali të vij edhe kopje fizike jo vetem elektronike, po në këtë raport kërkoj të di nga Drejtori se a janë përfshi puntorët që janë punësuar gjatë fushatës zgjedhore, si në arsim ashtu edhe në institucion të Komunës, edhe pse kjo i perket qeverisjes së kaluar. Po më vjen mirë që ish kryetari po merr pjesë në seanc por në mandatin e kaluar nuk ka qenë kur kemi kërkuar pergjegjësi. Këtë raport nuk do ta perkrahi pasi që nuk na ka ardh materiali në kopje fizike.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 12vota për, 2 kunder (Pranvera Kastrati Gashi, Abdyl Gashi) 1 apstenim aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

Aprovohet Raporti Vjetor Financiar i Komunës së Novobërdës për vitin 2021.

Pika e katërt: Aktivitetet rreth luftimit të pandemisë;

Kryesuesja tha: pasi nuk kemi propozues për këtë pikë po e shtyna për mbledhjen e ardhshme.

Pika e pestë: Raport nga D.SH.P.M.SH për aktivitetet e ndërmarrura gjatë periudhës së reshjeve të Borës;

Kryesuesja e falenderoi Drejtorin e SH.P që kanë mirëmbajtur të gjitha rrugët dhe ja kaloj fjalën që ta prezantoj këtë pikë.

Gafurr Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: permes këtij raporti ju informoj për pastrimin e rrugëve lokale dhe regjionale nga bora në Komunën e Novobërdës. Sa i perket rrugëve regjionale janë të pastruara nga Kompania ELBau nga Gjilani, që është e kontraktuar nga Ministria e Infrastruktures, kemi kontaktuar me kompanin përmes telefonit, për ti mirëmbajtur rrugët sa më mirë. Sa i perket rrugëve lokale, ne si Drejtori e Sherbimeve Publike kemi dal në terren çdo ditë prej datës 21.01.2022 deri më sot, ku jemi duke raportuar para jush. Ne si Drejtori e SH.P kemi një traktor për pastrimin e borës ku kemi punuar me kapacitete të plota me dy ndrrime për ti mirëmbajtur rrugët e pastruar, gjithashtu Komuna e ka angazhuar edhe një kompani tjetër për 200km për të na dal në ndihmë në disa fshatra, ju faleminderit. Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesja kaloi në piken e radhes.

Pika e gjashtë: Formimi i komisionit për vlerësimin e dhënjes së tokës Komunale në shfrytëzim;

Kryesuesja tha: duke pas parasysh se më dhënje në shfrytëzim të pronës Komunale Komuna do të formojm Komisionin për dhënje të pronës Komunale në shfrytëzim. Nga ekzekutivi janë propozimet vetem na duhen edhe dy propozime nga Kuvendit. propozimet nga ekzekutivi janë: Rrahim Ahmeti, Sladjana Natic, Jovan Simic nga sektori civil, kerkoj edhe propozimet nga Kuvendi.

Ivana Ivanovic pasi pershendeti të pranishmit dhe uroj antaren e re të Kuvendit propozi Negovan Jovanovic.

Ramush Mehmeti propozoi Vlora Vllasaliu.

Selatin Nuhiu tha: kërkoj që të shperbëhet ky komision njëher e pastaj të formohet komisioni i ri.

Kryesuesja tha: në momentin e perfundimit të mandatit ju kalon mandati edhe komisioneve, pasi që kemi mandatin e ri duhet edhe komisionet ti formojm të reja.

Selatin Nuhiu propozoi Abdyl Gashi.

Kryesuesja i hudhi në votim dy propozimet e para.

Me 12 vota për, 3 nuk kanë votuar aprovohet kjo pikë nga antarët prezent të Kuvendit dhe mirret ky:

VENDIM

FORMOHET Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për dhënjen në shfrytëzim të tokës Komunale në Komunën e Novobërdës me këtë përbërje:

- 1.Rrahim Ahmeti - Zyrtar i Kadastrit
- 2.Sladjana Natic – Menaxhere e personelit
- 3.Negovan Jovanovic – Antarë i Kuvendit
6. Vlora Vllasaliu – Antarë i Kuvendit
7. Jovan Simic – sektori civil

Pika e shtatë: Formimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave;

Kryesuesja tha: ky komision është i lidhur me komisionin e parë, ka të bëjë shqyrtimin e ankesave të aplikuesve për marrje në shfrytëzim të pronës Komunale, propozimet nga ekzekutivi i kemi Serboljub Djokic - Drejtor i Administrates, Naser Makolli - Asistent, Mirjana Artinovic nga sektori civil, kerkoj propozimet nga Kuvendi.

Ivica Cenic propozoi Stojan Stanojevic.

Kryesuesja kërkoi pauz 10min deri sa të kordinohen për propozimet e reja.

Pas pauzes 10 minuteshe mbledhja vazhdoi.

Ramush Mehmeti propozoi Abdyl Gashi.

Më 12 vota për, 1 apstenim dhe 2 nuk kanë votuar nga antarët prezent të Kuvendit aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

FORMOHET Komisioni për shqyrtimin e ankesave të aplikuesve për marrjen e pronës Komunale në shfrytëzim të rrefuzuara me këtë përbërje:

1.Serboljub Djokic - Drejtor i Administrates

2.Naser Makolli - Asistent

3.Stojan Stanojevic - Antarë i Kuvendit

6. Abdyl Gashi - Antarë i Kuvendit

7. Mirjana Aritonovic - sektori civil

Pika e tetë: Formimi i komisionit për emrimin e rrugëve;

Kryesuesja tha: ky komision është formuar edhe në mandatin e kaluar, por ende nuk ka përfunduar e gjithë puna, emërimi i rrugëve vetem në Komunën tonë nuk është përfunduar. Nga ekzekutivi i kemi propozimet: Sava Simic, Bojan Peric, Flamur Uka, kerkoj propozimet nga Kuvendi.

Ramush Mehmeti propozoi Pranvera Kastrati Gashi.

Stefan Kovacevic propozoi Milica Jovanovic.

Me 15 vota për nga të gjithë antarët e Kuvendit aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

FORMOHET Komisioni Komunal për Emërtimin e Rrugëve në Komunën e Novobërdës me këtë përbërje:

1. Sava Simic

2. Bojan Peric

3. Flamur Uka

4. Pranvera Kastrati Gashi

5. Milica Jovanovic

Pika e nëntë: Pruarja e vendimit për inicimin e procedurave për hartimin e planit zhvillimor Komunal.

Për këtë pikë ja dha fjalën Xhejlane Behluli.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: te nderuar antarë Komuna jonë ka hartuar një plan zhvillimor 10vjeçar 2012-2022+, pra në këtë vit skadon ky plan zhvillimor, që do të thot deri në hartimin e planit zhvillimor të ri, vlen ai plan zhvillimor sepse është 2022+. Duke e parë që Komuna jonë ka bërë një ndryshim dinamik si zonë turistike, na duhet që shumë shpejt të hartojm një plan zhvillimor të ri. Me ligjin e ri, plani zhvillimor komunal do të hartohet vetem për 8 vite. Sot nga ju anëtarë të Kuvendit kerkojm përkrahje unanime për inicimin e këtij plani, sepse është plan shumë më rëndësi tmadhe për

Procesverbali i Kuvendit

Komunën tonë. Na pret një punë mjaft me përgjegjësi, ku do të përfshihen të gjitha Drejtoritë, ekspert nga jashtë e ne veçanti barren më të madhe do ta ketë Drejtoria e Urbanizmit, andaj të nderuar antarë, ju premtoj se do të jemi transparent dhe llogaridhënës, për çdo proces të punës ndaj juve si Kuvend si akt më i lartë i Komunës, ju falemindert nese keni ndonjë pyetje do tju përgjigjem.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: unë mendoj është një iniciativë e mirë dhe jam që ta përkrahi dhe nese nuk gjejmë donator jam që të ndajmë një shumë buxhetore pasi që besoj se kemi buxhet të pasqepenzuar nga të hyrat vetanake.

Pasi nuk pati diskutime tjera aprovohet njëzëri kjo pikë nga antarët prezent të Kuvendit dhe mirret ky:

VENDIM

Me këtë vendim fillohen aktivitetet për plotësim ndryshimin e Planit Zhvillimor të Komunës së Novobërdës.

Pika e dhjetë: Pruarja e Vendimit për kompletimin e komitetit për Komunitete;

Kryesuesja tha: në bazë të Nenit 53 pika 53.1, të Ligjit Nr: 03/L- 040, për Vetqeverisja Lokale, Kuvendi i Komunës me datën: 17.12.2021, ka shpallur Ftes për Takime Publike me Qytetarë, ku ka mbajtur një takim në Sallën e Kuvendit Komunal të Novobërdës, ku i ka informuar qytetarët rreth procedurës së si aplikohet, dhe si plotsohen Formularët dhe grumbullimi i nënshkrimeve. Administarta e K.K-së, ka shpërndarë Formularët tek qytetarët e interesuar. Afati për dorzimin e formularve të plotësuar ka qenë deri më: 25.01.2022, por ngase nuk ka janë dorzuar të gjithë formularët, afati është shtyer pas diskutimit në Kuvendë deri më: 24.02.2022. Pasi që administarta e kuvendit ka pranuar Formularët e Nënshkruar, nga qytetarët e interesuar të të tri Komuniteteve. Kryesuesja në bashkpunim me administratë të K.K, ka shqyrtuar Formularët dhe nuk ka hasur në ndonjë përgjigje, andaj ka ardhur në përfundim që Kuvendit të Propozojë këta tre kandidat, që kanë grumbulluar më së shumti nënshkrime. Nga komuniteti Shqiptarë - Shqipe Mustafa, nga f.sh. Tullarë, 132 nënshkrime. Nga komuniteti Sërb Igor Vasic nga fshati Stanishor 121 nënshkrime, nga komuniteti Romë - zt. Edson Jashari, nga F.sh. Boston, 17 nënshkrime. Andaj propozojmë që Vendimi i marë me datën: 27.01.2022, për formimin e Komitetit të Komuniteteve që të plotsohet edhe me këta tre kandidatë nga Komunitete.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu tha: po nderlidhem te komuniteti shqiptarë që vetëm një person paska dorzuar nënshkrime, unë i kam informatat edhe për një person tjetër që ka dorzuar nënshkrime, a mirren parasysh edhe nënshkrimet e atij personi. Unë mendoj se Shqipe Mustafa nuk e përfaqëson komunitetin pasi që ka qenë në listë zgjedhore të LDK-së, kërkoj që të shqyrtohen edhe nënshkrimet tjera, nuk e di a ka pasur njoftim publik rreth afatit për dorzimin e listave.

Kryesuesja tha: dy herë është vazhduar afati, për kandidatin që po flisni listat i ka dorzuar sot 20 min para mbledhjes, afati i fundit ka qenë ditën e premte deri në ora 12:00, pastaj deri në ora 15:30 janë verifikuar nënshkrimet.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 13 vota për, 3 të përmbajtur aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

FORMOHET Komiteti për Komunitete të Komunës së Novobërdës me këtë përbërje:

1. Violeta Milosevic
2. Vlora Vllasaliu
3. Dobrivoje Djordjovic
4. Selatin Nuhiu

5. Shqipe Mustafa
6. Igor Vasic
7. Edison Jashari

Pika e njëmbëdhjetë: Pruarja e vendimit për plotësim ndryshimin e Rregullores Komunale për Taksa dhe Gjoha;

Për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalën Drejtorit të Financave Milos Denic.

Milos Denic tha: kërkoj falje që kjo pikë është futur kështu e nuk keni material, bazuar në nenin 12 pika 1 dhe nenin 12 pika 2 të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe sipas nenit 2 pika 3 Ligjit për Financa dhe nenit 34 të Statutit të Komunës së Novobërdës ne tani duhet të marrim vendim që të kemi të drejt ta ndyshojm Rregulloren për taksa dhe gjoha dhe në një nga Kuvendet e ardhshme do ta merrni këtë rregullore të ndryshuar dhe do të njoftoheni më kohë për të gjitha, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: e falenderoj Drejtorin për pregaditjen e raportit, nese keni ndonjë diskutim urdhëroni.

Stojan Stanojevic tha: duke lexuar ligjin dhe rregulloren mendoj se është e viti 2002/03 dhe kjo padyshim që duhet të ndryshohet dhe taksat duhet të jenë të harmonizuara në bazë të ligjit, e falenderoj Kryetarin që ka inicuar këtë procedur dhe Drejtorin që është këtu, shpresoj që në asamblenë e ardhshme të jetë e pregaditur kjo rregullore, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: mendoj se Drejtori është duhur të vij me ndryshime përkatëse në rregullore, si ta marrë miratimin tonë pa e ditë se çka do të bëjë, është mirë që të vij me ndryshime konkrete në mënyrë që të diem se sa do të ndikonte edhe të qytetarët në pagesa të taksave.

Kryesuesja tha: fillimisht nga ne kërkohet një vendim që këshilli ekzekutiv të filloj punën rreth kësaj Rregullores.

Ramush Mehmeti tha: kjo është një iniciativ dhe aprovimi i saj bëhet kur të vij versioni final.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 13 vota për dhe 2 apstenime aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

Aprovohet vendimi për plotësimin e ndryshimin e Rregullores Komunale për Taksa dhe Gjoha.

Pika e dymbëdhjetë: Pruarja e vendimit për shpalljen e Ankandit publik për shitjen e automjeteve të Komunës që janë jashtë përdorimit;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Administratës Serbojlob Djokic.

Serbojlob Djokic pasi pershendeti të pranishmit tha: më vjen keq që për këtë pikë nuk keni marrë materialin, kjo pikë bëhet fjalë që të kemi të drejtë të fillojm procedurat për shitjen e automjeteve të Komunës përmes ankandit publik. I kemi 25 automjete gjithësej, 23 janë në parking të Komunës, 1 është në prekovc, 1 në Koretishtë dhe 1 te automekaniki, për shitje janë 3 kombi, 1 Niva, 1 Astra, 1 Subar, duke u bazuar në procedurat e muajit Mars ose Prill të vitit të kaluar ku janë shitur disa automjete, fillimisht duhet ta formojm komisionin si Drejtori e Administratës dhe duhet ti dregojm kërkesë qenderes së regjistrimit të automjeteve për ti çlajmruar veturat.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu tha: e pershendes Drejtorin për raportin që ishte shumë i qartë dhe transparent, ne sot do ta përkrahim këtë iniciativ.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 13 vota për, 2 të përmbajtur aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

APROVOHET Vendimi për shitjen e atomjeteve të vjetëra dhe të zhvlersuara të Komunës së Novobërdës.

Pika e trembëdhjetë: Të ndryshme.

Kryesuesja tha: para se të hapi diskutimin ju njoftoj pasi për festen e 8 marsit, ashtu siç është festuar për çdo vit edhe në mandatin e kaluar e kemi pasur përkrahjen prej Kryesuesit, në mandatin e kaluar kemi qenë 5 femra dhe 10 meshkuj, ndërsa tani jemi 7 femra dhe 8 meshkuj. Siç e dini, në vitet e kaluara

organizuar një drekë nga Kuvendi ku merrnin pjesë të gjithë kolegët së bashku si dhe dhuratat për të gjitha antarët e Kuvendit dhe asistentët pra kemi 7 antare dhe 2 asistentët e Kuvendit. pra kërkoj nga ju që të biem një vendim që tju ndajmë një dhuratë në shumë prej 50€.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: kërkoj që kjo festë të festohet bashkarishtë Kuvend dhe Ekzekutiv në kordinim me kryetarin e Komunës si dhe të shqyrtohet mundësia e ndarjes së dhuratave të jetë e njëjtë.

Dobrivoje Djordjevic pasi pershendeti të pranishmit tha: unë jam kunder pasi që dhurat duhet të jetë dhurat e jo para, 9 femra të jenë para atyre që punojnë në Komunë n edhe për 8 marsë jamë kunder edhe në vitin e kaluar kam qenë kunder.

Kryesuesja tha: vlera e dhurates do të jetë 50€, nuk do të marrin dhuratë. Unë nuk e di sa punëtore janë në administarten Komunale si dhe buxheti ynë në Kuvend është i kufizuar por gjithsesi jemi në bisedime me Kryetarin e Komunës për çdo gjë.

Zyrtarja për barazi gjinore Sadbere Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: së pari e komplementoj këtë Kuvend që ka plotësuar Kuoten gjinore prej 30% ashtu siç kerkohet me ligjin për zgjedhjet e pergjithshme lokale ku shpresoj se në të ardhmen të rritet kjo kuot ashtu siç e percakton ligji për barazi gjinore. Me zgjedhjen e Kryesueses së Kuvendit është respektuar ligji për përfaqësimin gjinor, prandaj unë e përgëzoj Kryesuesen si dhe antarët e reja të Kuvendit me të cilat besoj se do të kemi një bashkpunim të mirë. Sa i perket Ditës ndërkombëtare të Gruas ne në kuader të planit të punës këtë vit kemi parapa edhe aktivitetet për këtë ditë, është planifikuar të shpallet java e barazisë së gruas në shkollë, ku në dy vitet paraprake qendra rajonale e OSBE-së në Gjilanë së bashku me Drejtorin e Arsimit dhe zyren për barazi gjinore ndërmuren iniciativën e quajtur java e barazisë gjinore në shkollë për të shënuar në mënyrë më gjithpërfshirëse ditën ndërkombëtare të gruas me qëllim sensibilizimi të nxënësve. Java e barazisë gjinore do të organizohet në të gjitha shkollat dhe do të realizohet në orët e historisë, ed. Qytetare dhe të gjuhës shqipe, mësimdhënësit do të ndihen të lire të harmonizojnë orën si lloj debati apo si prezantim apo si tematik e veçant e leterisë për gra. Si aktivitet tjetër kemi parapa që të jetë edhe një tryezë diskutimi brenda institucionit tonë Komunal ku temë e tryezës do të jetë pjesëmarrja e grave në vendimarrje, pasi që në këtë mandat Kryetari i Komunës me formimin e digastereve ku prej nëntë drejtorive gjithësej nuk kemi asnjë femër udhëheqëse, prandaj është më së e nevojshme që të ngrisin zërin rreth kësaj çështje dhe të diskutojmë, pra 8 marsi nuk është një ditë që duhet të festojmë e të marim dhurata por është një festë ku duhet ta ngrisin zërin dhe të reflektojmë për të drejtat tona që na takojnë me ligj. Pas tryezës do të kemi një drekë pune ku do të na servohet brenda lokalit të Komunës pasi që nuk është e lejuar për arsye të pandemisë që të mbledhemi në restorante, sa i perket dhuratat që u ceken nuk lejohen por të gjitha do të jemi së bashku të bashkuara në një drekë pune solemne, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: e falenderoj Sadberin për këtë prezantim dhe kërkoj nga antarët e Kuvendit që të votojnë për ndarjen në shumë prej 50€ dhuratë për femra antare dhe asistentët.

Abdyl Gashi tha: unë edhe në KPF kam qenë gjithmonë kunder këtyre shpenzimeve që bëhen çdo 8 marsë, mendoj se ka probleme të jashtëzakonshme të varfërisë në Komunë dhe mendoj se këtë buxhet kishte më mirë me nda me një vend ku është nevojë pasi që dihet se shumë gra rrisin jetimë dhe këto asambleistët tonë kishte qenë mirë të organizohet si aktivitet për t'ju dhuru ndonjë dhuratë e jo të ndahen 1000€ së paku vetëm për asamblesitet dhe stafin percjellës e ku është edhe pjesa tjetër e administratës Komunale, është një shumë e madhe duke përfshi edhe drekën.

Kryesuesja tha: nuk është 8 marsi që ti respektojmë ato gra vetushqyese pasi që kemi ditë tjera kur mundë të organizohemi e ti vizitojmë e ti ndihmojmë, 8 marsi është dita kur femrat kanë fituar të drejtat.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 12 vota për, 2 kunder (Abdyl Gashi, Dobrivoje Djordjevic) dhe 1 nuk ka votuar aprovetet propozimi i Kryesueses së Kuvendit që tju ndahet një çek në vlerë prej 50 euro për antarët e Kuvendit dhe 2 asistentët.

Stojan Stanojevic tha: znj.Kryesuese në mbledhjen e kalaur jemi pajtuar që të gjithë Drejtorët të marrin pjesë në mbledhje por Drejtori i Arsimit nuk është, kërkoj të dij pse disa punëtorë janë larguar nga puna 3 ditë para zgjedhjeve. Gjithashtu i kam 3 kërkesa nga banorët e fshatit Zebinc, kemi dy rrugë lokale për në lagjen e bullgarëve, dhe rruga tjetër lokale është lagja e Dolinës, këto janë dy lagjet në fshatin Zebinac që deri më sot kanë mbetur pa asfalt, të gjitha rrugët lokale që janë 300 m të gjata, problem tjetër është mungesa e grumbullimit të mbeturinave, kemi ankesa nga qytetarët dhe mësuesit e shkollave se në shkollën fillore, kemi ankesa edhe nga qytetarët në fshatin Prekovc se u është dobët rryma. I kthehem sërish Statutit të Komunës dhe ju drejtohem juve si Kryesuese që nese është e mundur të shtohet në rend dite formimi i komisionit për kthim. Gjithashtu e kam edhe një kërkes tjetër prej qytetarëve ku perveq këshilltarëve kërkojnë të zgjedhin edhe përfaqësuesit e fshatrave, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: e falënderoj kolegun Stanojevic, a kemi ndonjë gjë tjetër?

Dobri voje Djordjevic tha: problemi është te rruga në fshatin Stanishor, ne kemi pasur protesta rruga është nisur dhe është ndërprerë, andaj kërkoj nga qeverisja aktuale të bëjë zgjidhjen e të mos vazhdojm me protestat sepse kalojnë kamionet dhe ne kemi akoma te njejtin problem, nese nuk shtrohet shpejt ceshtja e vazhdimi te rruges do vazhdojme me protestat, vetem percjell kërkesat e qytetarëve, sepse çdo ditë kemi të njëjtin problem.


Kryesuesja tha: Sa i përket problemit të rrugëve ka pasur protesta dhe unë kam qenë prezent por nuk më kujtohet të të kam parë në ato protesta, tjetra është që ne duhet të kishim kërkuar një raport se çfarë ka ndodhur me ato rrugë sepse si Stanisor ka problem edhe Straza dhe Koretishta.

Milica Jovanovic pasi pershendeti të pranishmit tha: kërkoj një raport nga EccoHigiena se a kanë mjete që të ndrrrojnë kontinjeret pasi që shumë janë amortizuar.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit

